



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "EQREM ÇABEJ"
FAKULTETI I SHKENCAVE TE NATYRËS
GJIROKASTËR

Nr 922 Prot.

Gjirokastër, më 19.12.2019

VENDIM

NR. 5 DATË 19.12.2019

PËR

MIRATIMIN E RAPORTIT TË VEPRIMTARISË MËSIMORE-SHKENCORE TË FSHN-së
PËR VITIN AKADEMIK 2018-2019

MIRATIMIN E PLANIT STRATEGJIK TË ZHVILLIMIT TË FSHN-së
MIRATIMIN E RREGULLORES SË PËRDITËSUAR TË FSHN-së

Mbështetur në Raportet e Veprimtarisë Mësimore-Shkencore të Përgjegjësave të Njësive Bazë / Departamenteve të FSHN-së për vitin akademik 2018-2019; mbështetur në ligjin 80/2015 "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimit në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë" neni 43 pika 3 dhe në Statutin e Universitetit "E.Çabej" neni 20 pika 5; dhe në zbatim të akteve nënligjore të Ligjit 80/2015. Dekanati i Fakultetit të Shkencave të Natyrës në mbledhjen e tij të datës 19.12.2019

VENDOSI

1. Të miratojë Raportin e Veprimtarisë Mësimore-Shkencore të FSHN-së për vitin akademik 2018-2019.
2. Të miratojë Planin Strategjik të Zhvillimit të Njësisë Kryesore.
3. Të miratojë Rregulloren e përditësuar të Fakultetit të Shkencave të Natyrës.

Dekan

Prof. asoc. Dr. Sefiq Oruci





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "EQREM ÇABEJ"
FAKULTETI I SHKENCAVE TË NATYRËS
GJIROKASTËR

**STRATEGJIA E ZHVILLIMIT
AFATMESËM DHE AFATGJATË**

FAKULTETI I SHKENCAVE TË NATYRËS

Gjirokaster, Dhjetor 2019



PËRMBAJTJA

I. HYRJE.....	3
II. STRATEGJIA E ZHVILLIMIT AFATMESËM DHE AFATGJATE TË FAKULTETIT TË SHKENCAVE TË NATYRËS.....	4
1. Vizioni	4
2. Misioni	5
3. Vlerat	5
4. Qëllimi.....	5
5. Objektivat	6
6. Prioritetet Strategjike detyrat dhe problemet	6
7. Kapitali human dhe sistemet mbeshtetese:.....	7
8. Nderveprime jashte fushes akademike.....	8
III. MËSIMDHËNIA	8
1. Logjistika e fakultetit	8
2. Metodika e mësimdhënies	9
3. Raporti student/pedagog	9
IV. KËRKIMI SHKENCOR	9
V. EDUKIMI NË VIJIMËSI	10
VI. SHËRBIMET PËR KOMUNITETIN.....	10
1. Prioritete:.....	11



I. HYRJE

Fakulteti i Shkencave të Natyrës në UGJ ka zhvilluar në vijimësi politika të shëndetshme akademike, duke mbajtur në konsideratë prioritetet strategjike kombëtare e rajonale. Strategjia e Zhvillimit të Fakultetit të Shkencave të Natyrës, është një dokument i konceptuar dhe miratuar në trajtën e dokumentit zyrtar.

Në rang fakultetesh, puna e Njësisë Kryesore / Fakultetit të Shkencave të Natyrës, për tëformular plan-veprimin afatshkurtër dhe afatmesëm, është mbështetur mbi Vizionin dhe Konceptet Strategjike të çdo Njësie Bazë / Departamenti. Këta elemente kanë qenë në vijimësi të integruar nëkuadrin e raporteve periodike të vlerësimit të brendëshëm. Momentalisht, në përballje me sfidat që burojnë nga proesi i implementimit të Ligjit të Arsimit të Lartë të vitit 2015, lind nevoja e hartimit të një Strategjje Zhvillimi e cila do të shërbejë si referencë për konsolidimin e Fakultetit të Shkencave të Natyrës, në perspektivë afatmesme dhe afatgjatë.

Dokumenti në fjalë, është hartuar duke pasur si referencë kuadër Strategjite e miratuara prej Departamenteve të Fakultetit të Shkencave të Natyrës duke përmbledhur përparsitë strategjike të zhvillimit që secila Njësi Bazë ka identifikuar për të ardhmen afatmesme-afatgjatë.



II. STRATEGJIA E ZHVILLIMIT AFATMESËM DHE AFATGJATË TË FAKULTETIT TË SHKENCAVE TË NATYRËS

Fakulteti i Shkencave të Natyrës të Universitetit “Eqrem Çabej” Gjirokastër ka në përbërje Njësitë Bazë si më poshtë:

- a) Njësia Bazë e Matematikës, Informatikës dhe Fizikës
- b) Njësia Bazëe Biologjisë dhe Kimisë
- c) Njësia Bazë e Infermierisë

Në këtë përbërjendërthuret tradita (ish Departamentet themeluese të FSHN-së: i Matematikës, i Fizikës dhe i Bio-Kimisë), e tashmja dhe e ardhmja (shkencat kompjuterike, teknologjite e informacionit dhe komunikimit). Në këtë aspekt Fakulteti i Shkencave të Natyrës identifikohet si me degët themeluese fillimi të ILP dhe më vonëtë Universitetitë Gjirokastrës (Matematikë-Fizikë dhe Bio-Kimi), ashtu edhe me degët e tjera (Matematikë-Informatikë, Teknologji Informacioni, Fizikë dhe Teknologji Informacioni, Infermieri e Përgjithshme, Infermieri Mami) të cilat janë çelur ndër vite diktuar nga nevojat rajonale të tregut dhe ne fushen e arsimit te lartë.

1. Vizioni

Fakulteti i Shkencave të Natyrës ka zhvilluar projektin e vet strategjik ne kuader te veprimtarise strategjike te UGJ i cili synon te pershtatet e t'i paraprijë zhvillimit ekonomik e shoqeror te vendit. Ai synon te kthehet ne një qender te edukimit te vazhdueshem per Rajonin e Jugut. Fakulteti i Shkencave të Natyrës brenda tërësisë së Universitetit të Gjirokastrës do te vazhdojë te jete qender e fuqishme per arsimimin dhe kerkimin shkencor te orjentuar nga tregu i punes, nga reformat social-ekonomike, nga standartet e reja te integrimit evropian.

Fakulteti i Shkencave të Natyrës synon të identifikohet si pikë referimi në fushën e edukimit dhe përgatitjes së burimevenjerëzore të aftëa profesionalisht e të gatshëm të përballojnë sfidat dhe kërkesat e tregut të punës, sipas sektorëve strategjikë të zhvillimit rajonal dhe kombëtar. Fakulteti i Shkencave të Natyrës synon të ngrejë e të zhvillojë një mjesis arsimimi prestigjoz.

Vizioni: Te jete një ndër fakultetet me te mira te vendit dhe te krijoje një reputacion si një qender mesimore dhe kerkimore.



2. Misioni

Misioni i Fakultetit të Shkencave të Natyrës përpjekim me krijuar, zhvillimin, transmetimin dhe mbrojtjen e dijeve përmes mësimdhënies, kërkimit shkencor dhe shërbimeve akademike. Fokusi i Fakultetit të Shkencave të Natyrës ka qenë dhe mbetet formimi sa më cilësor dhe bashkëkohor profesional iburimeve njerëzore, duke maksimalizuar pritshmëritë e të ardhmes personale të secilitpër t'ju sfidave të zhvillimit kombëtar shqiptar.

3. Vlerat

Leadership, Integritet, Respekt, Bashkëpunim, Inovacion, Transparencë, Përgjegjësi, Efikasitet, Qëndrueshmëri.

Vlerat baze te cilat synohen me programet e studimit qe mbulohen nga Njësitë Bazë të Fakultetit të Shkencave të Natyrës kane te bejne me:

- **Punesimin:** Me programet aktuale te studimit dhe me programe te reja studimi te te gjitha niveleve qe duhen hartuar do te synohet rritja e mundesive per punesim te te diplomuarve ne keto programe studimi. Kjo do te arrihet duke pershtatur permbajtjen e ketyre programeve me nevojat e tregut te punes dhe nepemjet rritjes se cilesise se te diplomuarve ne keto programe.
- **Standartet akademike:** Nepermjet programeve aktuale dhe programeve te reja studimi te te gjitha niveleve qe do te hartohen praktika të punes promovuese perkatese, brenda mundesive dhe kuadrit ligjor do synohet per te motivuar frekuentimin e ketyre programeve te studimit prej nje kontigjenti studentesh sa me cilësorë. Kjo duhet te shkoje paralelisht edhe me diplomimin e tyre sa me cilesor në fushat përkatëse.
- **Lidhje me e ngushte me studentet:** Departamentet e FSHN do te synojne ngritjen ne nje nivel me te larte te marredhenieve te mira ekzistuese me studentet, si ne nivelin e mesimdhënies dhe në ate te kerkimit.
- **Cilesi e larte kerkimi:** Ne besojme se ne nje fakultet te shendoshe, mesimdhenia zhvillohet me se miri prej atyre qe kane eksperience te kryrjes se kerkimit dhe aktiviteteve te tjera qe lidhen me dijet ne nje disipline të caktuar dhe ne zoterimin e nje formimi të plotë e të përditësuar me arrritjet bashkëkohore të fushës.

4. Qëllimi

Fakulteti i Shkencave të Natyrës, historikisht mbetet i angazhuar në formimin dhe përgatitjen e studentëve si profesionistë të ardhshëm në fushat e tyre në mënyrë që të jenë pjesë aktive dhe efektive e tregut të punës në kushtet e konkurrencës për profesionalizëm të lartë si në nivel rajonal ashtu edhe kombëtar dhe mundësishët edhe ndërkombëtar.



5. Objektivat

Fakulteti i Shkencave të Natyrës ofron arsimim të fokusuar në përgatitjen e specialistëve për fushat e mësimdhënies dhe jo vetëm të matematikës, informatikës, fizikës, teknologjisë së informacionit, biologjisë, kimisë; të fushave përkatëse të infermierisë apo mamilisë. Objektivi ynë madhor është të qenë një qendër edukimi dhe arsimimi që nxjerr produkt dinjitoz për tregun e punës, si njëvlerë te shtuar për shoqërinë. Mbetet synim i përhershëm që diplomat e Fakultetit të Shkencave të Natyrës të ekuivalentohen dhe të kenë vlerë reale në tregun ndërkombëtar të punës.

6. Prioritetet Strategjike detyrat dhe problemet

Fakulteti i Shkencave të Natyrës ka hartuar paketën e Prioritetave Strategjike, të fokusuara në shtimin e llojshmërisë së kurrikulave akademike, orientuar kjo nga nevojat dhe prioritetet e zhvillimit të vendit. Prioritetet Strategjike të FSHN në terma arsimorë, kërkimore-shkencore dhe të kontributit ndaj shoqërisë shqiptare, janë në harmoni me Strategjinë kombëtare të Zhvillimit të Arsimit të Lartë, duke u fokusuar në:

- i. cilësinëe mësimdhënies gjithnjë e më të lartë;
- ii. kërkimin shkencor veçanërisht në fushat me interes për rajonin;
- iii. edukimin në vazhdimësi duke përdorur më së shumti teknologjitet e komunikacionit;
- iv. shërbimet e ofruara në komunitet në bazë të ekspertizës shkencore të stafit

Implementimi i tyre nuk mund të kryhet veçseme anë plan-veprimesh konkrete të cilat përfshijnë tërësinë e aktiviteteve akademike me shtrirje në çdo nivel të strukturës së fakultetit.

Detyrat dhe problemet me te rendesishme qe shtrohen perpara Fakultetit të Shkencave të Natyrës janë :

- rritja e nivelit te kualifikimit te personelit akademik e cila do te coje me pas ne rritjen e spektrit te fushave te interesit.
- ne hapjen e programeve te studimit te ciklit te dyte dhe te trete,
- ne hapjen e programeve te reja te studimit, te cilat kuptohet do te ndikojne ne rritjen e cilesise dhe me mbështetjen e strategjive qeveritare do te coje ne terheqjen e nje numri me te madh studentesh ne cilesi dhe ne sasi.
- Shqyrtimi i mundesive per te hapur programe afatshkurtra studimi me orientation profesional.



- Gjithashtu nje angazhim dhe mbeshtetje financiare eshte e nevojshme per nje permiresim rrenjesor te infrastruktures fizike te ambienteve mesimore dhe laboratorike.
- Gjithashtu, nje angazhim dhe mbeshtetje e metejshme kerkohet per te permiresuar ambientin akademik: rritjen e abonimeve ne periodiket shkencore, facilitete ne rritjen e vizitave shkencore akademike te profesoratit nga jashte departamentit, rritjen e mbeshtetjes financiare per kerkimin shkencor dhe botimet shkencore te kryer nga personeli akademik.
- Rritja e aktivitetit botues dhe pjesmarrjes ne konferanca dhe pse jo dhe ne organizimin e tyre.
- Ne kuadrin e permiresimit te metodave dhe permbajtjes se mesimdheneve dhe te nxenit, duke u mbeshtetur tek pervoja shume e mire dhe shume vjecare e Fakultetit si themelues i Universitetit, do te synohet perfshirja e eksperiencave te reja te sjella nga personeli akademik, vecanerisht ato te e-learning.
- Do te kerkohet per menya te reja ne drejtim te perfshirjes me te gjere dhe me aktive te studenteve ne procesin kerkimor dhe ne aktivitetin ekstra-kurrikular. Ne kuadrin e planeve te reja mesimore eshte parashikuar integrimi i te gjithe studenteve ne realizimin e tezave te diplomes ne formen e projekteve finale.
- Te punohet qe fakulteti me vlerat e tij te behet faktor konsulence, ekspertize, sherbimi dhe kerkimi per zhvillimin e rajonit ne bashkepunim me institucionet e sektorit publik dhe privat.
- Perdorimi i mekanizmave te ndryshme ligjore per te kryer vetvleresimin e cilesise se brendshme.

7. Kapitali human dhesistemet mbeshtetese:

- Te terheqe dhe te mbaje personel akademik, potenciali kerkimor i te cileve te jete i nje niveli sa me te larte, i matshem ne standarte kombetare, prania e te cileve jo vetem do te rrite produktivitetin e personelit ekzistues por do te kontribuoje edhe ne krijimin e nje grupi i cili te jete prezent ne nivelin kombtar.
- Te terheqe studente te talentuar dhe te motivuar ne programet e studimit qe mbulon fakulteti te te gjitha niveleve.
- Te siguroje dhe te ofroje lethesirat me te mira te mundshme per personelin akademik te departamentit dhe te studenteve te programeve te studimit qe ofron ai, ne menyre te vecante ne fushen e infrastruktures se IT, te bibliotekes dhe mbeshtetjes administrative.



8. Nderveprimejashtefushesakademike

- Tekrijojedhendjekebashkepunime me sektorinpublikdheprivat ne formen e kerkimit, projektevedhekonsulences.
- Tepromojojelijeratadherryezainformuese per edukiminnëshkencatnatyroredheinfirmierore ne bazekomunitetidhetepopularizoje keto shkenca ne gjithkomunitetin.
- Te promovoje aktivitetin e tij shkencor ne nje ambient me te gjere dhe jashte universitetit.
- Si njerin nga mjetet ndihmes dhe informues per realizimin e gjithe objektivave te siperpermendura konsiderohet perdorimi me efikas i ëeb-it e bazuar ne infrastrukturen moderne ekzistuese e të rinovuar ndër vite.
- Të mbahen lidhje dhe kontakte me te diplomuarit tane dhe te jemi ne korrent te punesimit te tyre.

III. MËSIMDHËNIA

Fakulteti i Shkencave të Natyrësosfron arsimim prej dekadalash dhe në vijimësi ndër vite duke upërmirësuar dhe duke u bërë më i larmishëm e më i përshtatshëm për nevojat e tregut të punës. Mësimdhënia në FSHN synon :

- Te konsolidoje programet ekzistuese te studimit të ciklit të parë dhe të dytë, që mbulohen prej Njësive Bazë / Departamenteve të FSHN-së.
- Te punoje per te hartuar dhe filluar programe të reja studimi te ciklit te dyte dhe te ciklit te trete.
- Te punoje per te hartuar programe nderdisiplinare me departamente te tjera brenda UGJ-se.
- Te siguroje nje ambient mesimdhene nxitës dhe motivues per studentet e programeve te studimit te gjitha niveleve.
- Te behet një qender mesimdheneze dhe trajnuese ne kete drejtim per gjithe komunitetin arsimor te jugut.

1. Logjistika e fakultetit

Ruajtja e infrastrukturës ekzistuese dhe shtimi i saj me infrastrukturëmoderne që ka ndikim të drejtpërdrejtë mbi cilësinë e punës së personelit të FSHN-sëpër kërkim shkencor dhe mësimdhënie bashkëkohore, është mbajtur gjithmonë në qendër të vëmendjes. Në këtë kuadër do te synohet drejt elementeve të nevojshëm dhe të domosdoshëm për një arsimim bashkëkohor si vijon:

- Përmirësimi i aseteve teknologjike dhe i bazës materiale,
- Zyra pune të pajisura me gjithë mjetet TIK për çdo pedagog,
- Salla moderne për simpoziume shkencore (në shërbim të fakultetit apo komunitetit)
- Auditore audiovizive vecanërisht për mësimdhënie me TIK,
- Rritja e numrit të simulatorëve dhe laboratorëve,
- Biblioteka on-line me literaturë të përditësuar në shkencat e natyrës.



2. Metodika e mësimdhënieς

- Përmirësimi, përditësimi dhe pasurimi me elementë bashkëkohorë i metodikës së mësimdhënieς: kalimi nga të mësuarit vetëm me ‘prezantim faktesh’ në të mësuarit interaktiv me në qendër studentin, të bazuar në zgjidhjen e problematikave, zhvillimi i mendimit kritik me synim zhvillimin tek studentët të atyre shprehive dhe kompetencave cilësisht të vlefshme për të ardhmen.
- Të diplomuarit synohet të jenë të përgatitur me shprehi të përgjithshme dhe të transferueshme, si ato të analizës, të të menduarit kritik, arsyetimit logjik, paraqitjes estetike dhe komunikimit, krijimtarisë dhe zgjidhjes racionalitetë problemeve, përtëj njojurive specifike të profesionit në fushat përkatëse.
- Do të zgjerohen mundësitë e trajnimit të stafit akademik në Didaktikë Pedagogjike duke ndërthurur eksperiencat më të mira teorike bashkëkohore me përdorimet praktiketë teknologjive të informacionit dhe komunikimit në funksion të mësimdhënieς.

3. Raporti student/pedagog

Synohet të ulet rapporti student/personel akademik drejt mesatares së BE (1:20). Synohet të shtohet numri i studentëve proporcionalisht me rritjen e kapaciteteve infrastrukturore dhe njerëzore të fakultetit, për të ofruar një shërbim në përputhje me standardet. Të sigurohet përshtatshmëria dhe zhvillimi i vazdueshëm i burimeve njerëzore në realizimin e misionit, strategjive dhe objektivave të programeve konkrete të studimit që mbulan fakulteti i shkencave të natyrës.

IV. KËRKIMI SHKENCOR

- Përditësimi i Strategjive të Kërkimit Shkencor, në bazë fakulteti dhe departamenti.
- Profilizimi i kërkimit shkencor sipas fushës së studimeve të departamenteve (grupeve kërkimore-shkencore brenda tyre), për të maksimalizuar impaktin e tij në rrjetin akademik por edhe në komunitet.
- Te krijoje një ambient që mbeshtet kerkimin shkencor perparimtar duke mbeshtetur dhe iniciativat per projekte kërkimore kombetare dhe lokale.
- Vazhdimi i traditës së zhvillimit të projekteve kërkimore të përbashkëta me aktore publikë e privatë rajonalë, kombëtarë e ndërkombëtarë për rritjen e ekspertizës shkencore në fushat përkatëse dhe për të ofruar shërbime cilësore në komunitet.



- Konsolidimi i lidhjes mes departamenteve të Fakultetit të Shkencave të Natyrës dhe tregut të punës sipas sektorëve përkatës duke shfrytëzuar projektet kërkimore-shkencore.
- Kërkimi shkencor do të jetë në funksion të përditësimit, rifreskimit e zgjerimit të bazës teorike dhe praktike të kurrikulës së studimeve, dhe ofrimit të shërbimeve komunitare.
- Te krijohen dhe te nxiten elemente te një qendre kërkimore dhe që ofron shërbime, ekspertiza, konsulenca dhe studime shkencore, kërkimore e zbatuese per komuniteten gjithe perfshires. Shtimi i numrit të aplikimeve të miratuara për projekte të përbashkëta kombëtare dhe ndërkombëtare. Kërkimi shkencor i secilit departament do të orientohet nga prioritetet e zhvillimit rajonal e kombëtar.
- Te rritet aktiviteti shkencor publicistik (artikuj, monografi, tekste, referime). Te rritet pjesmarrja ne konferanca shkencore kombetare dhe nderkombetare.
- Krijimi i lidhjeve të qëndrueshme me partnerë brenda dhe jashtë vendit.
- Te thellohet procesi i integrimit te studenteve te programeve te studimit te te gjitha niveleve ne procesin e kerkimit.
- Te ndjeke programet bashkepunuese me institucion me reputacion te larte kombetar dhe me institucion nderkombetare.

V. EDUKIMI NË VIJIMËSI

Do të organizohen aktivitete periodike me synim përditësimin e vazhdueshëm të personelit pasuniversitar me zhvillimet e fundit sipas fushave përkatëse.

Do të vazhdojë implementimi i Programeve të shkëmbimit dhe mobilitetit të pedagogëve me institucion të huaja të cilat kanë impakt mbi cilësinë e edukimit në vazhdimësi.

VI. SHËRBIMET PËR KOMUNITETIN

Fakulteti i Shkencave të Natyrës synon të marrë rolin e udhëheqësit shkencor për zhvillimin rajonal, i cili nisur nga potencialet njerëzore, intelektuale, materiale e natyrore mban lidhje të forta me komuniteten lokal dhe me vëmendje të veçantë ndaj prioriteteve të zhvillimit rajonal.

Roli i Fakultetit të Shkencave të Natyrës në ndihmë të zhvillimit rajonal, nënkuption që ai, krahas mësimdhënies, të ofrojë konsulencë dhe ekspertizë, kërkim shkencor të aplikuar dhe shërbime të tjera për të nxitur drejtpezhim më të mirë të potencialeve që rajoni disponon (ekzaminuese dhe promocionale). Në këtë kuadër ne synojmë gjithashtu të shërbejmë si

Strategja e zhvillimit të FSHN



katalizator për zgjerimin e hapësirave të punësimit dhe për orientimin e duhur të burimeve njerëzore të specializuara në treg, duke përfthuar në këtë mënyrë edhe të ardhura shtesë për fakultetin dhe universitetin. Për realizimin e këtij objektivi do të synohet:

- Rritja e numrit të shërbimeve që Fakulteti i Shkencave të Natyrës ofron për komunitetin. Zgjatja e kohës së ofrimit të këtyre shërbimeve.
- Zhvillimi i trajnimeve me grupet e interesit sipas fushave respektive.
- Edukimi i studentëve me filozofinë e jetës qytetare aktive të mbështetur në zgjedhje racionale dhe cilësore.

1. Prioritete:

Çelja e programeve profesionale te studimit dyvjecare, ne fushen e mjedisit, teknologjise, perqatitjen e laboranteve biokomikë etj. Profilizimi i kërkimit shkencor sipas fushës së studimeve të departamenteve (grupeve kërkimore-shkencore brenda tyre), për të maksimalizuar impaktin e tij. Kërkimi shkencor i secilit departament do të orientohet nga priorititetet e zhvillimit rajonal e kombëtar. Krijimi i lidhjeve të qëndrueshme me partnerë brenda dhe jashtë vendit.

Dekani

Prof. Asoc.Dr. Sefiq Oruci



Strategjia e zhvillimit të FSHN

